



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE**  
**KËSHILLI DREJTUES**

Nr. Prot. \_\_\_\_\_

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2022

**VENDIM**

**Nr. 32, datë 31.10.2022**

**PËR**  
**MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË BUXHETIN E**  
**AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE PËR VITIN 2022**

Në bazë dhe në zbatim të nenit 52, pika 1, shkronja “gj”, të nenit 53, pika 5, shkronja “f” të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 22, pika 1 dhe pika 2 dhe të nenit 24, pika 1 të rregullores “Mbi hartimin, miratimin dhe zbatimin e buxhetit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 34, datë 27.11.2020, si dhe të nenit 18, pika 2 të Rregullores të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e një ndryshimi në Buxhetin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2022, të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 36, datë 21.12.2021, si më poshtë vijon:
  - a. Hiqet zëri “Rack dhe Server - Disaster Recovery Site” nga shpenzimet kapitale, Kapitulli I “Aktive Afatgjata Materiale”, grupi III “Pajisje Informatike” me vlerë 6.900.000 (gjashtëmilion e nëntëqind mijë) lekë.
  - b. Hiqet nënzëri “Mirëmbajtje Disaster Recovery Site”, në zërin “Mirëmbajtje dhe riparime të mjeteve kryesore”, nga shpenzimet korrente, Kapitulli I “Shpenzime Operative”, grupi I “Shpenzime materiale dhe të ngjashme” me vlerë 650.000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.





- c. Shtohet zëri “Blerje pajisje informatike për rritjen e sigurisë së informacionit në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave” në shpenzimet kapitale, Kapitulli I “Aktive Afatgjata Materiale”, grupi III “Pajisje Informatike” me vlerën 7.550.000 (shtatë milion e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë) lekë.
2. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm të njoftojë Autoritetin Mbikëqyrës për miratimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sektori i Financës dhe Investimeve, Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Sektori i Administratës dhe Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Donald Duraj

Kryetar

Shqipe Malaj

Sekretare

